



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborui Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.892/2021**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi Kryesues, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Shtimes Ruzhdi Jashari, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

## **V E N D I M**

**I. Pranohet** i bazuar apeli Anr.892/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Shtimes, Ruzhdi Jashari nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimet 2201E/05D, 2202E/02R, 2214E/01D.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për Kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, në Komunën e Shtimes, në vendvotimet 2201E/05D, 2202E/02R, 2214E/01D.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë në Vendvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.892/2021, i Paraqitur nga kandidati për Kuvend Komunal Ruzhdi Jashari nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Shtime, me të cilën pretendon se në vendvotimet 2201E/05D, 2202E/02R, 2214E/01D, ka mos përputhje të rezultateve. Me apel ka bashkangjitur formular dhe deklaratë të votuesve, familjarëve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lëvizja Vetvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Shtime, Ruzhdi Jashari, kërkon rinumërimin e votave në vendvotimet e lartcekura, PZAP, pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i paraqitur nga kandidati në fjalë për rinumërimin e votave për vendvotimin e lartcekur është i bazuar .

Paneli vlerëson se apeli është mbështetur në provat e dorëzuara nga kandidati, ku shihet qarte se nga deklaratat e votuesve të bashkangjitura në shkresat e lëndës deklarojnë se në vendvotimet e pretenduara në apel e kanë votuar për kandidatin Ruzhdi Jashari, ndërsa votat që figurojnë në rezultatet përfundimtare të KQZ-së nuk përputhen me deklaratat e dhëna si dëshmi nga votuesit e që janë të bashkangjitura në apel. Gjithashtu shihet se në formularët e ofruar si dëshmi ka ndërhyrje në rubrikën e apeluesit prandaj, për të eliminuar te metat lidhur me rezultatin e saktë të votave, paneli vendosi që apelin ta pranoj si të bazuar.

Andaj ky panel, vlerëson se rinumërimi në këto vendvotime e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartcekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, gjithashtu në mbështetje të nenit 117.4 dhe po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 892/2021 më datën 07.11.2021



**Kryesues i Panelit**  
Burim Demi

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.